



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Projekt

RREGULLORE

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
TRANSPARENCË NË KOMUNËN E GJILANIT 01 NR. 2681 DT. 12.03.2008**

Gjilan, prill 2015

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 38 nën paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna, Kuvendi Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur me _____miratoi

**RREGULLOREN
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
TRANSPARENCË NË KOMUNËN E GJILANIT 01 NR. 2681 DT. 12.03.2008**

Neni 1

1. Në të gjitha nenet e rregullores bazë, fjalia “dokumente zyrtare” zëvendësohet me fjalinë “dokumente publike”.
2. Te neni 3 i rregullores bazë, fjalia “paragrafi 64.3” zëvendësohet me fjalinë “nenit 60 paragrafi 4”.
3. Te neni 4 paragrafi 4.2 në fund të paragrafit shtohet fjalia “përmes zyrtarit të zyrës për informim”.
4. Pas nenit 4 të rregullores bazë, titulli riformulohet dhe ka këtë përmbajtje “kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe peticioni”.
5. Te neni 5 i rregullores bazë, në fund të paragrafit 5.1 fjalia “të përcaktuar me ligj” fshihet dhe shtohet fjalia “prej 60 ditësh) dhe te paragrafi 5.2 numri “30” zëvendësohet me numrin “15”.
6. Te neni 6 i rregullores bazë, paragrafi 1 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje si në vijim ”Në pajtim me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të Statutit të Komunës dhe të dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje, Komuna detyrimisht mbanë të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

01. Nr. 110 ____
Gjilan me _____

KRYESUESJA E KUVENDIT

Valentina Bunjaku -Rexhepi

Duke pasur parasysh se është nxjerrë udhëzimi administrativ nr. 05/2013 për transparencë në komuna që në nenin 9 të saj përcaktohet obligimi për Kuvendin e Komunës që të miraton rregulloren komunale për transparencë në Komunë.

Në kuptim të kësaj Kryetari i Komunës në pajtim me nenin 58 pika h) dhe në zbatim të nenit 17 pika s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, inicion dhe i propozon Kuvendit të Komunës që të miratoj

**RREGULLOREN
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
TRANSPARENCË NË KOMUNËN E GJILANIT 01 NR. 2681 DT.
12.03.2008**

Qëllimi i miratimit të kësaj projekt-rregulloreje është harmonizimi i rregullores aktuale me udhëzimin administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna dhe harmonizimet kanë të bëjnë me nenet si në vijim:

- Në të gjitha nenet e rregullores bazë, fjalia “dokumente zyrtare” do zëvendësohet me fjalinë “dokumente publike” në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të Ligjit nr. 03/l-215 për qasje në dokumente publike,
- Të gjitha dokumentet e komunës për të cilat mund të jenë në dispozicion të publikut, qasja në to do të bëhet “përmes zyrtarit të zyrës për informim”.
- Kërkesat ose peticionet duhet të shqyrtohen nga Kuvendi i komunës në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit në Komunë kurse njoftimi për vendimin e marrë bëhet në afat prej 15 ditësh.
- Në pajtim me këtë projekt-rregullore dhe me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të Statutit të Komunës, sanksionohet rregulla që Komuna detyrimisht mban të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm.

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. **05/2013** për Transparencë në Komuna, është mbajtur edhe dëgjimi publik për këtë projekt- rregullore me datën **10.02.2015 (e martë) dhe me dt. 13.02.2015 (e premte)** në ora **13:30** me qytetarë, shoqata, grupet të interesit dhe institucione të komunës ku janë evidentuar të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e dalura nga dëgjimi publik.